

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, me seli në rr. Sv. Leopold Mandiq 10, Dugopolje, Republika e Kroacisë, përmes Maja Pargovska avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 02.07.2025, solli këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, me seli në rr. Sv. Leopold Mandiq 10, Dugopolje, Republika e Kroacisë, do të fitojë kontroll mbi TURE shoqëri për hotelieri, turizëm, ndërtimtari dhe tregti d.o.o., me seli në Porat 1, Postira (Komuna Postira), Republika e Kroacisë, edhe bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji), më datë 09.06.2025, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, me seli në rr. Sv. Leopold Mandiq 10, Dugopolje, Republika e Kroacisë, me të cilin ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti do të fitojë kontroll mbi TURE shoqëri për hotelieri, turizëm, ndërtimtari dhe tregti d.o.o., me seli në Porat 1, Postira (Komuna Postira), Republika e Kroacisë.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, ka si lëndë të veprimtarisë (veprimtari themelore) – veprimtari të agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë. ORVAS shoqëri

me përgjegjësi të kufizuar për tregti është një shoqëri e cila veçanërisht merret me veprimtari të agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë (e specializuar për shërbime të dhënies me qira të varkave me vela, motobarkave, katamaranëve, si dhe dhënies me qira të vilave turistike dhe akomodimit hotelierik në ishujt Hvar dhe Braç në Republikën e Kroacisë), dhe në masë më të vogël, si veprimtari dytësore, me aktivitete bujqësore (plantacione vetanake të vreshtave dhe ullinjve) për prodhimin e sasive të vogla të verës dhe vajit të ullirit të destinuara për shitje në kuadër të Grupit ORBICO.

ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti është pjesë e Grupit ORBICO dhe është 100% në pronësi të ORBICO SHPK për tregti Zagreb. ORBICO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë është një shoqëri e cila veçanërisht merret me tregti me shumicë dhe njëkohësisht është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Kroacisë për një numër të madh të brendeve që variojnë nga produkte për kujdes dhe bukuri, produkte ushqimore dhe jo ushqimorë, aparate teknike dhe elektrike, barna, lodra, tekstil, cigare, vajra motorikë dhe shumë produkte të tjera.

Grupi ORBICO është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes:

Shoqërisë për tregti dhe shërbime ORBICO SHPK Shkup, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Komuna Kisella Vodë, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut me lëndë kryesore të veprimtarisë tregti jo specializuar me shumicë. Shoqëria është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një numër të madh të brendeve të produkteve ushqimore, vajrave motorikë, baterive, parfumeve, ujërave tualeti dhe deodorantëve, kozmetikës dekorative, produkteve për higjienë personale, produkteve për kujdes, produkteve për mirëmbajtjen e higjienës në amvisëri.

TURE shoqëri për hotelieri, turizëm, ndërtimtari dhe tregti d.o.o. është një shoqëri e cila veçanërisht merret me veprimtari turistike në territorin e Republikës së Kroacisë (posedon Hotelin LIPA në Postira në ishullin Braç, Kroaci, i cili është caku kryesor i transaksionit) dhe të gjithë aktivitetin afarist e kryen ekskluzivisht në territorin e Republikës së Kroacisë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ

.